
LIGJ Nr.9920, datë 19.5.2008
PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Neni 54 - Kuponi tatimor

1. Kuponi tatimor është dokumenti i lëshuar me anë të pajisjeve fiskale apo të pajisjeve të tjera elektronike me aparat shtypshkrimi.
 2. Subjektet, që detyrohen të lëshojnë kupona tatimorë lëshojnë njëherazi edhe faturë, nëse shitja apo shërbimi i kryer është për një përdorim tregtar dhe, për këtë shkak, blerësi është i detyruar ta kërkojë faturën.
 3. Të gjithë tatimpaguesit e shitjeve me pakicë, që shesin mallra apo ofrojnë shërbime në mjedise apo njësi të përhershme, të hapura për publikun, duhet të instalojnë pajisje fiskale dhe të lëshojnë kupona tatimorë për çdo transaksion.
 4. Kuponi tatimor, i pashoqëruar me faturë, nuk njihet si dokument justifikues i shpenzimeve për blerësin, ushtrues të një veprimtarie tregtare.
- “5. Deri në datën 31.3.2016,** për të gjithë tatimpaguesit që kryejnë shitje me shumicë të mallrave të blerës, joushtrues të një veprimtarie tregtare (individë), shitjet me kupon tatimor, të lëshuar nga pajisja fiskale, nuk duhet të tejkalojnë 10 për qind të vlerës së tatueshme të mallrave të shitura në të njëjtën periudhë tatimore të muajit të vitit të kaluar, pa përfshirë TVSH-në. **Nga data 1 prill 2016,** tatimpaguesit, **që kryejnë shitje me shumicë të mallrave, nuk lejohen të shesin me kupon tatimor te blerës, joushtrues të një veprimtarie tregtare (individë).**” (Shtuar me ligjin 99/2015 dt.23.09.2015)

Neni 59 - Pagesat me para në dorë

1. Tatimpaguesit, persona fizikë apo juridikë, tregtarë, nuk mund të kryejnë ndërmjet tyre transaksione shitjeje ose blerjeje me para në dorë, kur vlera e transaksionit është më e madhe se 150 000 lekë.
2. Përveç detyrimeve të tjera, të parashikuara në këtë ligj, tatimpaguesi, në përputhje me legjislacionin tatimor, duhet të reklamojë në vende të dukshme, çmimet e mallrave dhe të shërbimeve që ofron. ***Në rastet kur ushtron njëkohësisht tregti me shumicë dhe me pakicë, është i detyruar që t'i organizojë këto veprimtari në vende të veçanta, të ndara nga njëri-tjetri.***

Drafti i udhezimit të Procedurave që pritet të dale

Pas pikës 54.5, shtohet pika 54.6, me këtë përmbajtje:

“54.6. Deri në datën 31.3.2016, për të gjithë tatimpaguesit që kryejnë shitje me shumicë të mallrave të blerës, joushtrues të një veprimtarie tregtare (individë), shitjet me kupon tatimor, të lëshuar nga pajisja fiskale, nuk duhet të tejkalojnë 10 për qind të vlerës së tatueshme të mallrave të shitura në të njëjtën periudhë tatimore të muajit të vitit të kaluar, pa përfshirë TVSH-në. Përshembull, në rast se një distributor, ka realizuar gjatë muajit dhjetor 2014 , 100 milion lek mall të shitur (pa tvsh), gjatë muajit dhjetor 2015, distributorit i lejohet të shesë produktet e veta tek individët, deri në masën 10 milion lek.

Në këtë kufizim, nuk përfshihen tatimpaguesit (prodhues apo importues) të cilët tregtojnë me shumicë për tatimpagues të tjerë të regjistruar, por njëkohësisht kanë si pjesë të biznesit të tyre edhe njësitë e tregtimit me pakicë për publikun (rrjet dyqanesh) të pajisura me NIPT-e sekondare dhe pajisje fiskale.

Automjetet e pajisur me NUIS-e sekondare, të cilat përdoren për shitjet me shumicë “derë më derë”, nuk konsiderohen njësi të tregtimit me shumicë.